



LISTA KONTROLLI PËR ÇRREGULLIMET NEUROZHVILLIMORE TEK FËMIJËT E MOSHËS 5-10 VJEÇ



Save the Children

Manual për prindër e mësues



Save the Children

LISTA KONTROLI
PËR ÇRREGULLIMET
NEUROZHVILLIMORE TEK FËMIJËT
E MOSHËS 5-10 VJEÇ
(manual për prindër e mësues)

Përgatiti: Prof. Dr. Milika Dhamo

Tiranë, janar 2016

Botimi i këtij manuali u mundësua nga Save the Children

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne punojmë në 120 vende të botës. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre dhe i ndihmojmë ata të përmbushin potencialin e tyre.

Tiranë, 2017

Ky manual hartohet në kuadrin e projektit “Arsimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri” i mbështetur dhe i financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim AID 010155/STC/ALB dhe i zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe shoqatën MEDPAK.

Manuali është vlerësuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit .

Autor:

Prof. Dr. Milika Dharmo

Koordinatorë projektit:

Msc. Dhurata Nixha

Redaktorë shkencorë:

Instituti i Zhvillimit të Arsimit -IZHA

Redaktor gjuhësorë:

Msc. Olger Brame

Materialet e këtij botimi mund të riprodhohen, të ruhen në sisteme të përdorueshme apo të transmetohen në forma e mënyra elektronike, mekanike apo duke u fotokopjuar, pa patur nevojë për të marrë leje më parë nga “Save the Children”, por në çdo rast duke cituar burimin, nga i cili janë marrë.

Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi.

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
1-Listë kontrolli për fëmijët me disleksi	4
3. Listë kontrolli për fëmijët me dispraksi	7
4-Listë kontrolli për fëmijët me disgrafi	8
5-Listë kontrolli për fëmijët me hiperaktivitet	8
6-Listë kontrolli për fëmijët me çrregullim të vëmendjes me/pa hiperaktivitet	10
7-Listë kontrolli për fëmijët me autizëm	12
8-Listë kontrolli për fëmijët me çrregullim të përpunimit të informacionit shqisor	13
9-Listë kontrolli për fëmijët me çrregullim të komunikimit	15

HYRJJE

Janë të shumtë prindërit dhe mësuesit që vërejnë sjellje apo vështirësi të çuditshme të fëmijët/nxënësit e tyre, kur duhet të mësojnë një gjë të re. Sado që përpiqet vetë fëmija, prindi apo mësuesi, sjelljet e çuditshme mbeten të pranishme dhe ndërhyjnë në kryerjen me sukses të detyrave në shkollë, shtëpi apo komunitet.

Të tilla mund të jenë vështirësi të lidhura me gjuhës së folur dhe të shkruar (nuk shqiptojnë dot tinguj të caktuar, mezi mësojnë shkronjat dhe të lexojnë, bëjnë shumë gabime në detyrat e shtëpisë, vuajnë me matematikën, ankohen se u dhemb koka, sytë, barku, shpina kur bëjnë detyrat e shtëpisë, shmangin të folurën). Një grup tjetër fëmijësh vuajnë nga mungesa e përqendrimit (shihen nga të tjerët si të hutuar, harraqë, të paorganizuar, të pavëmendshëm apo si shumë të lëvizur, që nuk lënë “dy gurë bashkë”, që gjenden shpesh në mes të sherrit e rrëmujës, që ngacmojnë të tjerët, që janë sherrxhinj e të dhunshëm). Disa fëmijë të tjerë kanë vështirësi të çuditshme me të prekurit, të nuhaturit, të dëgjuarit, të të parit, të shijuarit dhe të ekuilibrit. Ata nuk durojnë dot erërat e forta, të mira e të këqija, irritohen kur rrobat u prekin trupin, ankohen nga zhurma e frigoriferit, neonit, fshesës së korrentit, bëjnë shtratin shumë rrëmujë kur flenë, bien nga krevati natën, etj. Ata mund të mos ndiejnë dhimbje, shije, frikë si çdo fëmijë tjetër. Disa të tjerë kanë vështirësi kur koordinojnë atë që shikojnë a dëgjojnë, me atë që bëjnë. Ata etiketohen si “syplasur”, “duartharë”, “humbameno”. Në disa fëmijë vërehen karakteristika të tjera të çuditshme.

Duket se fëmija është i mbyllur, autik, nuk ka emocione, nuk përfshihet në lojë me fëmijë të tjerë. Madje, duket sikur as nuk e kupton as si luhet. Këta fëmijë duket se nuk dinë as të dëshpërohen, as të ankohen, as të kërkojnë, e as të kundërshtojnë. Duan gjithmonë rregullin e tyre, nuk mësojnë dot gjëra të reja, nuk përshtaten, mësohen me diçka dhe nuk duan ta ndërrojnë: as orenditë, as jastëkun as batanijen, as bluzën. Por, ka disa fëmijë që i habisin mësuesit, sepse janë shumë të zgjuar, shumë të aftë, po paraqesin vështirësi specifike në lexim, shkrim dhe matematikë.

Të gjithë këta fëmijë vijnë në shkollë dhe duan të kenë sukses. Vështirësitë që shkolla u paraqet janë të mëdha, por vështirësia më e madhe për këta fëmijë (mendohet se është rreth $\frac{1}{4}$ e masës së nxënësve) është të bindin prindërit dhe mësuesit se ata e duan suksesin, por nuk mundin të mësojnë, së paku, atë dhe ashtu si shkolla dhe e përditshmja ua ofrojnë.

Mësuesit dhe shkolla duhet t’ia bëjë të mundur suksesin çdo fëmijë, pavarësisht vështirësive dhe aftësive. Për fëmijën me vështirësi në të nxënë, shkolla (mësuesi, psikologu i shkollës, mësuesi i arsimit special, specialisti nga drejtoria arsimore) dhe prindi hartojnë një Plan Edukativ Individual në përshtatje me nevojat specifike të fëmijës që burojnë nga çrregullimi i të nxënit që bart. Shpeshherë, ndodh që fëmija të ketë jo një po disa çrregullime njëkohësisht.

Nëse fëmija ka nevojë edhe për terapi speciale, ai referohet në sistemin e shërbimeve mjekësore dhe të psikologjisë klinike jashtë shkollës.

Puna për diagnostikimin e fëmijës me çrregullime në të nxënë dhe hartimin e një plani edukativ individual fillon me vrojtimin e sjelljes. Prindërit në shtëpi dhe mësuesit në klasë mund të mbështeten në këtë manual që ka lista sjelljesh për çdo çrregullim të të nxënit, për të bërë vrojtimit e tyre. Fëmija vrojtohet për një kohë relativisht të gjatë (1-6 muaj).Vrojtimet ndërpriten kur fëmija është i sëmurë dhe merr mjekim. Kujdes bëhet për të kuptuar nëse sjelljet janë karakteristike për fëmijën, apo vijnë nga stresi në familje, veset e ushqyerjes dhe sëmundjet kronike (infeksione, alergji, PKU).

Nëse sjelljet që vërehen janë karakteristika të vështirësive në të nxënë, mësuesi dhe prindi flasin me psikologun shkollor për të filluar punën për diagnostikimin dhe ndërtimin e një programi edukativ individual, i cili do të mundësonte zhvillimin dhe suksesin e fëmijës në shkollë dhe në jetë.

1-Listë kontrolli për fëmijët me disleksi

Leximi dhe e folura	Po	Jo
Ngatërron shpesh shkronjat në dukje të ngjashme: /d - bl/; /u - nl, /m - n/		
Ngatërron shpesh shkronjat e tingujve të ngjashëm: /v/, /f/, / th/		
Ngatërron shpesh fjalët me rend të përmbysur: /tana-nata/		
Ngatërron shpesh fjalë të ngjashme: /largoi, agoi/		
Ngatërrohet në leximin e fjalëve të njohura më parë		
Ndërron vendin e fjalës së parë dhe të fundit të fjalisë: /topi goditi rretën/ : /rrjeta goditi topin/		
Gabon kur lexon fjalë të shkurtra: /prej, për, nga, tek, për nga/		
Ngatërron rendin e fjalëve në fjali		
Ngatërron rendin e rreshtave në paragraf		
Lexon pa gabime, por nuk e kupton atë që lexon		
Ul zërin në fund të fjalës (nuk dëgjohet kur shqipton fundin e fjalës)		
Harron të lexojë fundin e fjalëve (mbaresat, prapashtesat)		
Harron të lexojë pjesë fjale, fjalie a paragrafë		
Harron udhëzimet e dhëna		
Nuk njeh simbolet dhe përdorimin e tyre (/+/, /-/, /x/, /:/, /!/ , /?/)		
Humbet radhën e muajve të vitit, ditëve të javës, numrave		
Nuk arrin të mësojë orën		
Ka probleme me menaxhimin e kohës		
Harron rima/vjersha të thjeshta		

Shkrimi	Po	Jo
Ngatërron dorën e majtë dhe të djathtë, nuk di kë të përdorë kur fillon të shkruajë		
Shtrëngon lapsin/stilolapsin fort		
Humbet drejtimin e shkrimit (del nga rreshti, kutia)		
Humbet njëtrajtshmërinë e të shkruarit (shkrim i madh dhe i vogël)		
Harron shkronjat e mëdha të dorës dhe/ose i përdor gabim		
Harron të shkruajë fundin e fjalës		
Keqformon shkronjat dhe numrat		
Injoron strukturën e faqes së shkruar (shkruan në margjina, cepa, anash fletës)		
Bën gabime kur kopjon nga tabela/libri		
Ka “ditë të mira” dhe” ditë të këqija” me shkrimin		
I shkruan shkronjat mbrapsht / i harron shkronjat		
Nuk di ku të fillojë në një faqe të re		
Ka probleme me orientimin majtas-djathtas		
Ka vështirësi në plotësimin e vendeve bosh me fjalë e numra		
Afron kokën shumë te fleta/ nxjerr gjuhën, shtrëngohet kur shkruan		
Gabon në pikësim		

Matematikë	Po	Jo
Ka vështirësi të bëjë veprime aritmetike me mend		
Ka vështirësi në kthimin e numrave mbrapsht /12 : 21/		
Ka probleme me shkrimin e numrave sipas rendit /63 : 36/		
Ngatërron numrat		
Shikon numra që nuk janë në libër apo fletore		
Ka probleme me gjetjen e shumës/mbetjes me mend		

KUJDES !

Nëse te fëmija vërehen 5 nga pohimet e mësipërme, ka shumë gjasa që fëmija të ketë disleksi. Ai ka nevojë për program edukativ individual. Ai duhet referuar te shërbimet psikologjike në shkollë për vlerësim të mëtejshëm.

Nëse te fëmija vëzhgohen më pak se 5 nga karakteristikat e mësipërme, fëmija me gjasa nuk ka disklesi. Mësuesi konsultohet me prindin, e referon fëmijën tek psikologu dhe përshtat metodat e mësimdhënies me stilin e të nxënit të fëmijës.

2-Listë kontrolli për fëmijët me diskalkuli

Karakteristika të fëmijës	Po	Jo
Ka vështirësi me dëgjimin		
Ka vështirësi për të kuptuar çfarë dëgjon me vesh		
Ka mungesë vëmendjeje		
Ka vështirësi të ndjekë informacionin verbal		
Ka probleme me renditjen, organizimin e informacionit		
Ka probleme me kuptimin e koncepteve dhe simboleve		
E ka të vështirë të krahasojë figurat, numrat		
Has vështirësi kur numëron		
Ngatërrohet në njohjen e numrave		
Ka vështirësi të tregojë se çfarë përfaqëson një numër realisht		
I harron numrat		
Nuk arrin të klasifikojë në mënyrë logjike, sipas formës, madhësisë, ngjyrës		
Nuk tregon dot numrin përfaqësues të një bashkësie		
Nuk bën dallimin: më i vogël / më i madh		
Nuk riprodhon dot të dhënat e një ushtrimi në matematikë		
Nuk zgjidh dot problemet në matematikë		
Nuk dallon dot njësitë me bazë 10: 10, 20, 30...		
Nuk e mban mend radhën e veprimeve në matematikë		
Nuk përdor dot fjalët kyç në matematikë: <i>mbledh, zbres, ndaj, shtoj</i>		
Nuk kupton brendinë e veprimeve kryesore në matematikë		
Nuk bën dot matje		
Shmanget nga lojërat që kërkojnë takt për t'u zgjidhur		
Nuk tregon dot kohën/orën		
Nuk planifikon dot kryerjen e detyrave në kohë		
Ka vështirësi për të vlerësuar koston / çmimin e një artikulli		
Ka vështirësi në arsyetimin matematikor		
Nuk kryen dot veprimet matematikore njëri pas tjetrit		
Nuk kupton dot sa kohë ka kaluar në një veprimtari		
Ndesh vështirësi në kryerjen e veprimeve të njëpasnjëshme me mend (-, +, :)		
Ka vështirësi në zgjidhjen e një problemës me dy mënyra		
Ka vështirësi me hartimin e problemës në matematikë		
Ka vështirësi në identifikimin e të dhënave kritike për zgjidhjen e një probleme		

KUJDES !

Nëse te fëmija vërehen 5 nga pohimet e mësipërme, ka shumë gjasa që fëmija të ketë diskalkuli. Ai ka nevojë për program edukativ të veçantë në matematikë. Ai duhet referuar te shërbimet psikologjike në shkollë për vlerësim të mëtejshëm.

Nëse te fëmija vërehen më pak se 5 nga pohimet e mësipërme, mësuesi përshtat metodat e mësimdhënies me natyrën e të nxënit të fëmijës. Ai bisedon me prindërit dhe e referon fëmijën te shërbimet psikologjike.

3. Listë kontrolli për fëmijët me dispraksi

Karakteristika	Po	Jo
Ka vështirësi për të mbajtur lugën, pirunin, lapsin, gërshërët në duar		
Ka vështirësi të kryejë veprimtari të ndryshme motorike		
Ka vështirësi në automatizimin e lëvizjeve (mbërthimi i pullave pa i parë)		
Ka vështirësi në shkrimin e dorës		
E ka të vështirë të ecë në korridoret e shkollës, klasës pa u përplasur		
E ka të vështirë të bëjë punë të rëndomta fizike (të rregullojë krevatin)		
Ka koordinim të varfër të syrit me dorën dhe këmbën		
Ka vështirësi të ecë në sipërfaqe jo të lëmuara		
Ka vështirësi në ngjitjen dhe zbritjen e shkallëve		
Ka paaftësi në mësimin e lëvizjeve harmonike ritmike		
Ka vështirësi të mësojë sekuenca lëvizjesh (valle)		
E ka të pamundur të riprodhojë lëvizje të mësuara më parë		
Ka kontroll të dobët mbi motorikën gros dhe fine		
Përjeton ankth kur lëviz në një drejtim fiks (mbi një vijë, tra, urë)		
Ka vështirësi në veshjen e rrobave në dimër		
Ka vështirësi të kontrollojë sendet personale: i derdh, i rrëzon, i thyen		
Është i avashtë, pa humor të mirë dhe i zyrtë		
Etiketohet në familje si rrëmujaxhi		
Ka vështirësi të manipulojë pjesë të vogla si: legot, puzzles, peta, rruaza		
Ka vështirësi me kopsat, butonat, tokëzat dhe zinxhirët kur vishet		
Nuk mëson dot të lidhë këpucët		
Nuk ka sukses në lojërat me dorë (top, basketboll, piano)		
Nuk mëson dot të ngjyrosë duke qëndruar brenda vijave të figurës		
Nuk prodhon e as nuk kopjon dot punime artistike		
Ka vështirësi në përdorimin e gërshërëve		
Është i ngathët me lapsin		
Vonon të mësojë të shkruajë		
E ka shkrimin të madh e të pakujdesshëm		
Shpesh shkrimi është i palexueshëm as nga nxënësi vetë		
Artikulon më gabime tinguj të ndryshëm		
I ka ardhur goja me vonesë		
Ka shkrim dore të varfër: të palexueshëm, me hapësira të pabarabarta, mungesë uniformiteti të shkronjës, humbje të drejtimit të shkrimit		
Nuk i mirëmban fletoret: i ka të grisura, të zhubrosura, me njolla, të fshira		
Është i avashtë në punët më shkrim		
Frustrohet kur ka detyrë me shkrim		
Mënjanon orët e leximit, shkrimit dhe të vizatimit		
Nuk kupton përmbajtjen e pjesëve të shkruara		
Ka vështirësi të kapë fjalët/idetë kyçe në një pjesë leximi		

KUJDES !

Nëse vëreni më shumë se 5 pohime, fëmija ka gjasa të ketë dispraksi. Ai ka nevojë për program edukativ individual. Referojeni te shërbimet psikologjike në shkollë për vlerësim të mëtejshëm. Nëse keni më pak se 4 pohime, duhet të përshtatni mënyrën e shfaqjes së fëmijës ndaj lëvizjes, duhet të qartësoni udhëzimet për detyrat dhe të monitoroni ecurinë e fëmijës.

4-Listë kontrolli për fëmijët me disgrafi

Karakteristika	Po	Jo
Ka vështirësi të ndjekë me sy atë që shkruan		
Ka vështirësi me hapësirën mes shkronjave, me qëndrimin brenda vijës gjatë shkrimit		
Ka shkrim të keq (keqformon shkronjat)		
Hutohet nga shkronjat e ngjashme, të tilla si ' b, d, q , dhe p 'ose', u, v, n , dhe m ' 		
Nuk kontrollon pozicionin e gishtave apo lëvizjen e tyre gjatë shkrimit		
Është i ngathët kur shkruan		
E kap lapsin në mënyrë të çuditshme kur shkruan		
Ka ton të ulët të muskujve të dorës dhe ton të shtuar të shpatullave kur shkruan		
Ka vështirësi të përdorë lapsa me diametër të ndryshëm		
Preferon të shkruajë me shkronja shtypi dhe jo me ato korsive		

KUJDES !

Nëse vëreni më shumë se 5 pohime nga lista e mësipërme, fëmija ka gjasa të ketë disgrafi. Ai ka nevojë për program edukativ individual. Referojeni fëmijën te shërbimet psikologjike në shkollë për vlerësim të mëtejshëm.

Nëse vëreni më pak se 5 pohime nga lista e mësipërme, duhet të përshtatni mënyrën e shfaqjes së fëmijës ndaj temave të reja, duhet të qartësoni udhëzimet dhe të monitoroni ecurinë e tij/saj.

5-Listë kontrolli për fëmijët me hiperaktivitet

Karakteristika të fëmijës hiperaktiv	Po	Jo
Është gjithmonë në lëvizje të paqëllimtë		
Nuk rri dot ulur		
Kur është ulur, lëviz këmbët, luan duart, prek sende pa qenë nevoja		
Rrëzon pa dashje thujse gjithçka përtokë		
Nuk mban dot pa derdhur një gotë uji, qumështi		
Ka probleme me përdorimin e lugës, thikës dhe pirunit		
Përplasat kur ecën më njerëz, mure, shtylla, dyer		
Pengohet në pragje, shkallë		
Pengohet e rrëzohet pa ndonjë arsye të dukshme		
Ngjitet dhe zbret shkallët duke u mbajtur, kërcyer, pa prituri të alternojë këmbët		
Ka vështirësi të qëndrojë me një këmbë me sy të mbyllur		
Ka vështirësi të lidhë lidhëset e këpucëve		
Ka vështirësi të mbërthejë kopsat		
Ka probleme me tregimin e orës		
Ka vështirësi në ruajtjen e rreshtit/radhës: shpesh e humb atë		
Kur shkruan, e kap lapsin shumë fort		
Kur shkruan, ndryshon duart: herë të djathtë e herë të majtë		
Ndryshon drejtimin dhe formën e shkrimit		
Nuk ruan drejtimin sipas vijave kur shkruan		
Shkruan edhe në margjinat e faqes		
Gabon kur kopjon figura gjeometrike (rreth, katror, trekëndësh...)		
Gabon kur kopjon diçka nga tabela		

KUJDES !

Nëse te fëmija vëzhgohen më shumë se 5 karakteristika nga lista e pohimeve të mësipërme, ka gjasa që fëmija të ketë hiperaktivitet. Mësuesi e referon tek shërbimi psikologjik në shkollë për vlerësim të mëtejshëm.

Nëse te fëmija vëzhgohen më pak se 5 karakteristika nga lista e pohimeve të mësipërme, mësuesi modifikon mënyrën e mësimdhënies, duke e përshtatur atë me stilin e të nxëniet të fëmijës.

6-Listë kontrolli për fëmijët me çrregullim të vëmendjes me/pa hiperaktivitet

Karakteristikat:	Shumë shpesh	Shpesh	Ndonjëherë	Asnjëherë
Nuk u kushton vëmendje detajeve				
Ka vështirësi të ruajë vëmendjen në detyra apo veprimtari të ndryshme				
Duket sikur nuk dëgjon kur i flet				
Nuk i ndjek udhëzimet				
Bën gabime nga pakujdesia				
Nuk arrin të përfundojë detyrat dhe punët				
Ka vështirësi në organizimin e vogël të punës				
Shmanget, nuk i pëlqen, apo nuk ka dëshirë të angazhohet në detyra të cilat kërkojnë përpjekje të qëndrueshme mendore (të tilla, si: detyrat e shtëpisë)				
Humbet gjërat e nevojshme për detyrat ose veprimtaritë (lodrat, detyrat, lapsat, librat, fletoret ose mjetet)				
Hutohet me lehtësi nga stimujt e jashtëm				
Etiketohet nga të afërmit dhe shokët si “harraq”				
Nuk përqendrohet në detyrat që i kupton mirë				
Nuk fokusohet në punët që i duhen				
Ka vështirësi të presë radhën				
Nervozohet				
Çorganizohet				
Nuk i dorëzon detyrat edhe kur i ka përfunduar				
Nuk e bën “hesap kokën” (futet në telashe shpejt)				
Nuk e kupton si i ikën koha				
Ka prirje të heshtë për problemet e veta				
Nuk përshtat reagimin me situatën				
Të tjerët e etiketojnë si “kokëfortë”				
Nxehet shpejt dhe bëhet i dhunshëm				
E ka të vështirësi të ndryshojë veprimtari				
E tepron me fokusimin në një veprimtari				
Ka shkrim të palexueshëm e plot gabime				
Ka vështirësi në detyrat e gjuhës dhe / ose matematikës				
Është keqdashës, mizor ose ngacmues				
Është ankthioz, nervoz, i shqetësuar				
Është i fiksuar pas disa mendimeve ose frikërave				
Shfaq episode të shkurtra irritimi disa herë në ditë				
Shfaq episode të shkurtra trishtimi disa herë në ditë				

Është i fiksuar pas ritualit/rendit të të bërit të gjërave				
Ka tike: bën lëvizje përsëritëse ose zhurma ritmike				
Ka kontakt të varfër me sy				
Nuk i ruan kontaktet shoqërore				
Ka interesa dhe ndërveprime të kufizuara				
Ka ndjeshmëri të pazakontë ndaj tingujve, prekjës, erërave apo shijes				
Ka vështirësi në koordinim				
U jep përgjigje pyetjeve para se t'i ketë dëgjuar ato				
Nuk pret radhën				
Ndërpret ose ngacmon të tjerët				

KUJDES !

Nëse më shumë se 5 prej pohimeve të mësipërme vërehen “Shumë shpesh” dhe/ose “Shpesh”, fëmija ka gjasa të ketë çrregullim të vëmendjes me ose pa hiperaktivitet. Mësuesi e referon fëmijën për vlerësim të mëtejshëm tek shërbimi psikologjik shkollor.

Nëse 5 prej pohimeve të mësipërme vërehen “Ndonjëherë” mësuesi ndryshon metodologjinë e mësimdhënies, duke e përshtatur atë me nevojat e fëmijës dhe e rekomandon në shërbimet sociale shkollore për të vlerësuar gjendjen familjare të fëmijës

7-Listë kontrolli për fëmijët me autizëm

Karakteristika të fëmijës (mund të raportohen që prej moshës 3 vjeç)	Po	Jo
Tendon të lëkundet, të kërcëjë pupthi, të ecë në majë të gishtave		
Nuk ka interes për fëmijët e tjerë e as të shoqërohet me ta		
Preferon të rrijë vetëm		
Nuk lejon t'i afrohet apo ta prekë dikush		
Nuk i kupton lojërat "gjasme"		
Nuk përdor gishtin tregues për të treguar nga vetja (pjesët e trupit) apo objektet pranë		
Nuk ka interes të eksplorojë mjedisin rrotull tij		
Preferon lodra të vogla		
Nuk shfaq kërshtëri(interes) për funksionimin e objekteve		
Nuk ka kontakt me sy		
Nuk toleron dot zhurmat (mbulon veshët me duar)		
Nuk i përgjigjet buzëqeshjes me buzëqeshje		
Nuk imiton		
Nuk përgjigjet kur e thërrasin në emër		
Nuk ndjek me shikim objektet që i tregohen		
Alternon ritmin gjatë ecjes		
Nuk drejton shikimin nga gjërat kryesore në mjedis, apo andej nga shohin të tjerët		
Bën lëvizje të pazakonshme të dorës, gishtit afër fytyrës së tij / saj		
Nuk tërheq vëmendjen e prindit/mësueses në gjërat që bën		
Bën që prindi/mësuesja të dyshojnë se mos fëmija nuk dëgjon		
Nuk kupton se çfarë i thuhet		
I ngul sytë në asgjë ose i rrotullon pa qëllim		
Nuk pyet		
Nuk ankohet		
Nuk kërkon ndihmë		

KUJDES !

Nëse vëzhgohen më shumë se 5 nga karakteristikat e mësipërme, fëmija mund të ketë autizëm. Mësuesi e referon tek shërbimet psikologjike në shkollë për vlerësim të mëtejshëm. Nëse vëzhgohen më pak se 5 nga karakteristikat e mësipërme, mësuesi ndryshon metodat e mësimdhënies, duke i përshtatur ato më shumë me stilin e të nxënit të fëmijës.

8-Listë kontrolli për fëmijët me çrregullim të përpunimit të informacionit shqisor

Karakteristika	Po	Jo
Refuzon të shkojë në kinema, koncert, vizita, market se nuk duron dot zhurmën		
Shpërqendrohet nga tinguj si tik-taket e orës, zhurma e frigoriferit, apo neonit		
Ka frikë nga zhurmat e forta si: tharësja e flokëve, fshesa e korrentit, lehja e qenit		
Nuk toleron rrëmujën/zhurmën: kërkon që të tjerët të mbajnë qetësi		
Mbyll veshët ndaj zhurmave të forta e të paparashikueshme		
Preferon volum të lartë të muzikës apo TV		
Nuk përgjigjet kur e thërrasin në emër		
Konfuz në të kuptuarin e origjinës së tingullit		
Flet me zë të lartë me vete kur bën detyrat		
Pyet shpesh "çfarë?"		
Ka vështirësi për të treguar ku e prekin nëse nuk shikon vendin		
Në familje dhe në shkollë e etiketojnë "rrëmujaxhi"		
Ka frikë nga errësira		
Fut sende në gojë		
Ka vështirësi në përdorimin e koncepteve fizike si: masa, forma, temperatura dhe koha		
Shmang lojën me litar, paralele, lisharës ose me patina		
Preferon detyra sedentare		
I përzihet në makinë, ashensor, shkallë lëvizëse		
Ka frikë nga lartësia dhe shkëputja e këmbëve nga toka		
Qan kur i hedhin ujë në kokë (kur lahet, në pishinë)		
Trembet nëse dikush e shtyn apo e merr hopa		
Dëshiron shumë të vërtitet dhe kërkon lëvizjen e vrullshme		
Ka dëshirë të qëndrojë përballë erës së fortë		
Mund të rrotullohet për orë të tëra dhe nuk i përzihet		
Hipën mbi tavolina e mobilje		
Adhuron lartësitë		
Gjithmonë hidhet në vend të ecjes normale dhe kërkon të kapërcejë sende nëse janë përtokë		
Tund kokën, trupin, ose këmbët gjatë të qëndruarit ulur		
Është aventurier		
Reagon negativisht ndaj erërave që nuk i pëlqejnë		
Iu vë në dukje të tjerëve erën e trupit, parfumit, ushqimit të tyre		
Refuzon të hajë për shkak të erës së ushqimit		
Irritohet nga era e parfumit		
Mërzitet nga era e shokëve në klasë ose era e ushqimit të tyre		
Refuzon të shkojë në shtëpitë e të afërmeve për shkak të erës që kanë		
Qëndron me dikë se i pëlqen era e tij/saj		
Ka vështirësi në dallimin e erërave		

Mund të helmohet pasi nuk konstaton erën e keqe të ushqimit		
Përdorim të tepruar të nuhatjes së objekteve apo individëve		
Nuk arrin të shohë gjithë pamjen, por sheh vetëm detajet		
Nuk gjen dot me lehtësi sendet kur janë mbi njëri tjetrin		
Ka vështirësi të ndjekë objektet me sy		
Nuk dallon dot ngjyrat, format dhe largësitë		
Ngatërron të majtën me të djathtë		
Ankohet se shikon dyfish		
Lodhet shpejt kur punon me figura		
Nuk arrin të vendosë dot një formë në një mozaik		
Ka probleme me perceptimin në 3 përmasa		
Është i ndjeshëm ndaj dritës së fortë, mbyll sytë, qan dhe ankoet për dhimbje koke		
Fërkon sytë shpesh		
Shmang kontaktin me sy dhe parapëlqen të luajë në mjedis të errët		
Vonon të mësojë shkronjat		
Fletoret i mban rrëmujë, i ka të paplotësuara dhe me shkarravina		
Ka vështirësi për të kujtuar format e shkronjave dhe numrave		
I shkruan shkronjat dhe numrat së prapthi		
Nuk krijon hapësira të barabarta ndërmjet shkronjave dhe fjalëve		
Harron shkronjat në fjalë dhe fjalët në fjali		
Bën gabime kur kopjon		
Bën gabime në lexim		
Nuk dallon gabimet në punën që bën		
Ka vështirësi në përgatitjen dhe organizimin e punës me shkrim		
Ngatërron shkronjat e ngjashme si (b dhe d , p dhe q)		
Ka vështirësi për të njohur dhe kujtuar fjalët e zakonshme		
Shpesh humbet vendin kur është duke lexuar		
Ngatërron fjalët e ngjashme dhe të kundërta		
Nuk rendit dot kërkesat në zgjidhjen e një probleme në matematikë		
Ka vështirësi në memorizimin e fakteve matematikore		
Nuk mëson dot tabelën e shumëzimit		
Harron formulat		
Ka vështirësi për të interpretuar grafikët, tabelat, hartat dhe diagramet		
Ka vështirësi në përballimin e niveleve më të larta të koncepteve matematikore		
Ngatërron të majtën me të djathtë		
Ka vështirësi për të vlerësuar kohën, për të qenë në orar		
Ka vështirësi të mësojë drejtimin/rrugën për në një vend të ri		
Ka vështirësi të llogarisë shpejtësinë dhe largësinë		
Ka vështirësi të shkojë te “pika kryesore”; ngec në të dhëna dytësore		
Nuk i kupton gjendjet shpirtërore dhe ndjenjat e të tjerëve		
Nuk ka aftësi organizuese		

Shpesh i humbet sendet personale		
Nuk i dallon objektet edhe kur i ka në një vend të dukshëm		
Nuk i preferon gjëgjëzat apo lojën “kukamshefthi”		
Ka vështirësi të ndërtojë strategji për të fituar një lojë, sepse nuk kupton qëllimin		

KUJDES !

Nëse vërehen më shumë se 5 tipare nga pohimet e mësipërme, fëmija ka gjasa të ketë vështirësi të përpunimit të informacionit që merr përmes një apo disa shqisave. Ai mund të ketë nevojë për program edukativ individual. Mësuesi/prindi e referon në shërbimin psikologjik shkollor për vlerësim të mëtejshëm.

Nëse vërehet prania e më pak se 5 nga pohimet e mësipërme, mësuesi përshtat metodat e mësimdhënies me stilin e të nxënit të fëmijës.

9-Listë kontrolli për fëmijët me çrregullim të komunikimit

Karakteristika të të folurit	Po	Jo
I ka ardhur goja me vonesë		
Ka arritur të artikulojë tingujt saktë më vonë se bashkëmoshatarët		
Nuk ka intonacion në përshtatje me të folurit		
Harron emrat e objekteve dhe njerëzve		
Ka fjalor të pakët		
I mungon rrjedhshmëria e të folurit		
Ka shumë “fill up-s/” (ëëëë, mmm, dmth, më kupton)		
Të folurit është i avashtë, i zvargët		
Bën gabime sintaksore kur flet		
U këput fundin fjalëve (fundi i fjalës është i padëgjueshëm)		
Ngatërron tingujt e ngjashëm		
Ngatërron fjalë që rimojnë		
Zhvendos rendin e rrokjeve në një fjalë		
Prodhon hibride fjalësh		
Lëviz trupin kur flet		
Përdor gjestet e duarve dhe lëvizjet e vetullave kur flet		
Shmang të folurën (kryesisht përballë të huajve, figurave autoritare ose grupit)		
Nuk e gëzon një pjesë të recituar bukur		
Nuk ka interes për librat dhe historitë e rrëfyera		
Nuk përshtat përgjigjen me pyetjen		
Nuk i kupton dhe/ose nuk i kujton udhëzimet		

Karakteristika të të lexuarit	Po	Jo
Është prapa bashkëmoshatarëve në të lexuar		
Ka vështirësi të tregojë shkronjat		
Ka problem për të gërmëzuar tingujt		
Ngatërron tingujt në një fjalë		
Ka vështirësi në renditjen e shkronjave kur shkruan një fjalë		
Hamendëson kur lexon		
I mungojnë teknikat e dekodimit (gjetjen dhe lidhjen e shkronjës me të tjerat në një fjalë)		
Lexon ngadalë		
Fillon leximin saktë, por shumë shpejt bllokohet		
Nuk kupton atë që lexon, sidomos në fjali të gjata dhe të përbëra		
Ka vështirësi në mësimin e fjalëve të reja në një pjesë leximi		
Shmang të lexuarit		

Karakteristika të të shkruarit	Po	Jo
Detyrat me shkrim janë të shkurtra, të paplotësuara, me fjalor të kufizuar		
Bën gabime gramatikore		
Bën gabime të çuditshme të shkrimit (jo fonetike);		
Mund të mos jetë në gjendje të deshifrojë/lexojë shkrimin e vet		
Idetë në detyrat me shkrim janë të organizuara varfër, nuk paraqiten në mënyrë logjike		
Liston gjëra të thjeshta: nuk jep ide e as përshkrime		
Në teste përgjigjet për pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë, jo për ato që duan zhvillim		

Karakteristika të fëmijës në lëndën e matematikës	Po	Jo
Jep përgjigje të avashtë		
Nuk ndjek udhëzimet		
Injoron faktet matematikore		
I korrigjon shpesh numrat		
Ka vështirësi me problemet që kanë fjalë		
Has vështirësi në zhvillimin e shprehive në matematikë		
Ka vështirësi në arsyetimin analitik dhe logjik		

Karakteristika të tjera	Po	Jo
Ngatërron numrat e telefonit		
Keqkupton atë që dëgjon nga mësuesi në klasë, nga prindi në shtëpi në radio apo TV		
Ka vështirësi në interpretimin e metaforave, fjalëve të urta, figurave letrare		
Ka vështirësi të marrë pjesë në lojëra fjalësh e të bëjë shaka		
Nuk e kupton kur e vënë në lojë		
Ka vështirësi në krahasimin e të ngjashmeve dhe dallimin e të kundërtave/ të ndryshmeve		
Ka vështirësi në klasifikim dhe grupim sipas tipareve të ngjashme		
Ka vështirësi në të kujtuarit e informacionit të duhur në një çast të caktuar		
Nuk prodhon ide origjinale		
Ka vështirësi në paraqitjen e një ideje ose projekti		
Ka vështirësi të mbajë një bashkëbisedim		

KUJDES !

Nëse vërehen më shumë se 5 karakteristika nga lista e pohimeve të mësipërme, atëherë fëmija mund të ketë çrregullime të komunikimit. Ai referohet pranë shërbimit psikologjik për vlerësime të mëtejshme.

Nëse vërehen më pak se 5 karakteristika nga lista e mësipërme e pohimeve, mësuesi përshtat metodat e mësimdhënies me stilin e të nxënit të fëmijës.



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org

[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)



Savethechildrenal



SaveChildrenAlb